



## Ç'është Pedibus ?

Pedibus është një «rresht» me fëmijë që shkojnë në këmbë nga shtëpia në shkollë, nën drejtimin e një të rrituri. Çdo prind që e regjistron fëmijën e vet në Pedibus regjistrohet edhe vetë për t'i shoqëruar ata, sipas nevojave e sipas një radhe të caktuar.

## Një rrugë plot gjëra të reja !

Qysh prej 20 vjetësh, ATE-ja e promovon Pedibusin kudo në Zvicër, për të kontribuar në sigurinë dhe shëndetin e fëmijëve, si dhe për të nxitur ecjen në këmbë dhe qarkullimin me mjete lëvizëse jondotëse. Rruga me Pedibus krijon çaste të volitshme për të biseduar njeri me tjetrin e për të vrotuar natyrën rreth e qark : lulet, pemët, blerimin, kafshët, insektet... Jep mundësinë për të zbuluar çdo ditë gjëra të reja e argëtuese !



Bashko pikat njera me tjetrën dhe ngjyros vizatimin. Ndoshta këtë vizatim e ke parë edhe më parë rrugës për në shkollë !

## Ç'të mira sjell Pedibus

- Siguri dhe mëvetësi për fëmijët
- Veprimtari fizike të përditshme
- Pakësim të ndotjes së mjedisit
- Forcim të miqësisë dhe lidhjeve shoqërore
- Kursim kohe për prindërit

Me mbështetjen e zyrës romande të Shoqatës së transporteve dhe mjedisit



ATE Association transports et environnement  
Bureau romand  
Rue des Gares 9, 1201 Genève  
Tél. 022 734 70 44  
coordination.pedibus@ate.ch  
www.pedibus.ch

VCS Verkehrs-Club der Schweiz  
ATE Association transports et environnement  
ATA Associazione traffico e ambiente



## ATE Pedibus



Bashkohu me këtë lëvizje!

VCS Verkehrs-Club der Schweiz  
ATE Association transports et environnement  
ATA Associazione traffico e ambiente



## Të krijosh një linjë Pedibusi është e lehtë!

### 1 Thuajuni edhe prindërve të tjerë!

Dy familje mjaftojnë për të çelur një linjë Pedibusi. Bashkohuni me familjet e interesuara !

### 2 Kontaktoni zyrën e bashkërendimit (Coordination Pedibus).

Ajo do t'ju ndihmojë për të krijuar linjën tuaj Pedibus dhe do t'ju furnizojë me material sigurie.

### 3 Përcaktoni mënyrën e funksionimit.

Bashkë me prindërit e tjerë, vendosni për itinerarin, ndalesat dhe rregullat e linjës suaj.

## Si funksionon Pedibusi?

Fare thjesht. Është njëloj si autobusët, por në këmbë.

- Itinerari dhe orari caktohen në përputhje me nevojat e familjeve.
- Shoqëruesit janë prindër ose njerëz të rritur të besuar.
- Fëmija i bashkëngjitet Pedibusit te stacioni më i afërt, që tregohet me tabelë.



## Material sigurie dhe informimi

Për marrjen e informacioneve të mëtejshme, telesharkimin apo porositen falas të materialit, hyni në sitin [www.pedibus.ch](http://www.pedibus.ch)

- Sigurim për aksidentet dhe përgjegjësinë civile
- Jelekë dhe shirita reflektues
- Reflektorë drite
- Tabela ndalimi
- Afishe dhe fletë informuese



## Zyra e bashkërendimit (Coordination)

Shoqata e transporteve dhe mjedisit -ATE ka ngritur zyra të Bashkërendimit kantonal (Coordinations cantonales), të cilat i shoqërojnë prindërit në aventurën e Pedibusit, duke i këshilluar e i mbështetur ata në krijimin dhe mbajtjen e linjave.

### Friburg

fribourg@pedibus.ch  
076 430 05 58

### Gjenevë

geneve@pedibus.ch  
022 344 22 55

### Zhyra

jura@pedibus.ch  
032 544 16 13

### Zvicra gjermanike

pedibus@verkehrsclub.ch  
031 328 58 46

### Tiçino

ticino@pedibus.ch  
076 801 16 51

### Vale

valais@pedibus.ch  
076 690 51 68

### Vaud

vaud@pedibus.ch  
076 330 83 58



Mos harro të na dërgosh një fotografi të vizatimit tënd në e-mail-in e mëposhtëm : [coordination.pedibus@ate.ch](mailto:coordination.pedibus@ate.ch), si përgjigje, ti do të kesh një befasi të këndshme.